



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 26.2.2025

Nr: 202

Ora: 14:00

VENDIM

PËR

**SHOYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË POLITIKE PARTIA “ALEANCA PËR
BARAZI DHE DREJTËSI EUROPIANE”, ME KRYETAR Z. VALENTINO
MUSTAKA, PËR REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET
PËR KUVEND TË DATËS 11 MAJ 2025**

Sot më datë 26.2.2025, në seancë publike mora në shqyrtim kërkesën nr. 1284 Prot., datë 25.02.2025, me:

Kërkues: Partia politike “Aleanca Për Barazi dhe Drejtësi Europiane”, me kryetar Z. Valentino Mustaka.

Objekti: Regjistrimi i partisë politike “Aleanca Për Barazi dhe Drejtësi Europiane” si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025.

Baza ligjore: Neni 64 i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

V Ë R E J:

Presidenti i Republikës me Dekretin nr. 399 datë 5.12.2024, ka caktuar datën 11 Maj 2025 për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvend.

Partia “Aleanca Për Barazi dhe Drejtësi Europiane”, nëpërmjet Kryetarit, Z. Valentino Mustaka, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvend që do të zhvillohen më datë 11 Maj 2025.

Bashkëlidhur kërkesës është paraqitur dokumentacioni vijues:

- a) Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, datë 25.02.2025, nëpërmjet të cilit vërtetohet se Partia

Data: 26.2.2025 Nr: 202
Ora: 14:00



Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike Partia “Aleanca Për Barazi dhe Drejtësi Europiane”, me Kryetar Z. Valentino Mustaka, për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025

- “Aleanca Për Barazi dhe Drejtësi Europiane”, me initiale “ABDE”, me Kryetar Z. Valentino Mustaka, rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre.
- b) Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02).
 - c) Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike (Model KQZ-04-03).

Nga dokumentacioni si më sipër dhe nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

- a) Emri zyrtar i partisë është Partia “Aleanca Për Barazi dhe Drejtësi Europiane” me shkronja nistore “ABDE”, me adresë: Lagjia 17, Rruga "Prokop Sorra", Nr. 978, Durrës;
- b) Kryetari i partisë është Z. Valentino Mustaka, me adresë: Bulevardi “Gjergj Fishta” Tiranë;
- c) Financieri i partisë është Zj. Miranda Gerdeci, me adresë: Rruga "Myslym Keta”, Lagjia nr. 10, ish Dega Ushtarake, Tiranë;
- ç) Personi përgjegjës për komunikim me KQZ-në është Z. Edmond Petraj, me adresë: Bulevardi “Gjergj Fishta”, Tiranë;
- d) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Kërkesa e paraqitur nga Partia “Aleanca Për Barazi dhe Drejtësi Europiane”, respekton afatin kohor të parashikuar në pikën 1, të nenit 64, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Dokumentacioni bashkëshoqërues i kërkesës, i paraqitur nga Partia “Aleanca Për Barazi dhe Drejtësi Europiane” është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 64, pika 2 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1 shkronja “n”, e 2, 64 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, si dhe të Udhëzimit nr. 2, datë 22.01.2025, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 11 Maj 2025.

V E N D O S :

1. Regjistrimin e partisë politike Partia “Aleanca Për Barazi dhe Drejtësi Europiane”, me kryetar Z. Valentino Mustaka, me shkronjat nistore “ABDE”, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI